



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për fillimin e vitit të ri akademik 2018-2019.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Fatmir Velaj, Vilma Bello, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj dhe Bujar Çela.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Lindita Nikolla - Ministre e Arsimit, Rinisë dhe Sportit,
Rezana Vrapit – drejtore e Përgjithshme e Qendrës së Shërbimeve Arsimore,
Arian Xhelaj – drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar,

Ejona Isufaj – drejtore e Drejtorisë së Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit,

Maringlen Mërtiri – këshilltar i Kabinetit të Ministrit,

Jetlir Gjergji – drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëdita të gjithëve!

Sot jemi mbledhur në seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për fillimin e vitit të ri akademik 2018-2019. Kjo seancë dëgjimore po zhvillohet sipas kalendarit të komisionit. Ne e kemi shtyrë këtë mbledhje, duke pritur kolegët e opozitës që të merrnin pjesë, por, fatkeqësisht, ata nuk kanë ardhur as sot. Megjithatë, ne jemi të vendosur ta vazhdojmë aktivitetin e komisionit tonë.

Para se të dëgjojmë zonjën ministre, unë dua t'ia kaloj fjalën kolegut Ylli, për të na thotë nëse ne kemi kuorumin për të filluar mbledhjen ose jo.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë, 10 anëtarë të komisionit dhe ne mund të vazhdojmë. Unë përsëri po e theksoj me keqardhje se opozita, e cila e ka kërkuar këtë seancë dëgjimore për fillimin e vitit të ri akademik me ministren e Arsimit, nuk është e pranishme, ajo vazhdon dhe bojkoton komisionin.

Milva Ekonomi – Faleminderit shumë, zoti Ylli!

Para se t'ia jap fjalën ministres, dua të përmend që në datën 17 tetor, kur filloi viti i ri akademik 2018-2019, kolegu Nasufi, me konsensusin e të gjithëve ne, anëtarëve socialistë të komisionit, u uroi studentëve shqiptarë një vit të mbarë akademik. Nga ky çast ne menduam që do të ishte shumë mirë që t'ju dëgjonim ju, zonja Ministre, se cilat janë masat që keni marrë për një vit të suksesshëm akademik.

Të gjithë kolegët kanë ndjekur me vëmendje të rejtat e fundit të paraqitura në medie lidhur me ndryshimet në ministri, për sa i takon arsimin të lartë. Gjithashtu, ne jemi në dijeni edhe të disa shkresave që kanë ardhur në komision për situatën e arsimit të lartë në vend. Kështu që shpresoj të ndajmë të gjitha shqetësimet dhe përgatitjet tuaja për këtë vit të ri akademik.

Lindita Nikolla- Faleminderit!

Zonja kryetare,

Të nderuar kolegë,

Përtej ditës kur kolegu i nderuar uroi fillimin e vitit të ri akademik, unë dua të shpreh mirënjohjen për angazhimin tuaj në punët që janë bërë në Ministrinë e Arsimit, por edhe në mbështetje të të gjitha ndryshimeve ligjore, ku nuk kam parasysh vetëm sistemin e arsimit të lartë, por edhe atë parauniversitar.

Sigurisht që fillimi i vitit të ri akademik përfaqëson një ndër detyrat dhe aktivitetet kryesore, që kanë një planifikim të përvitshëm nga Ministria e Arsimit, për realizimin e të cilave përfshihet jo vetëm institucioni i Ministrisë së Arsimit, por, pa dyshim, edhe institucionet e arsimit të mesëm dhe të lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar e të tjerë. Unë gjej rastin të falënderoj dy përfaqësuesit dhe dy drejtuesit e këtyre dy qendrave, zonjën Vrapit, drejtuese e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, si dhe zotin Xhelaj, drejtues i Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, ku falë punës dhe angazhimit të tyre personal, por edhe stafit të tyre, ne ia kemi dalë që për të tretin vit radhazi implementimi i skemës së re të pranimit në universitete po funksionon perfekt, duke mos pasur asnjë problematikë, vërejtje apo kritikë si nga studentët, ashtu edhe nga prindërit apo institucionet tona të arsimit të lartë. Reforma jonë për zgjedhjen meritë/preferencë është kryer në kushtet e plota të transparencës dhe bëhet në bazën e autonomisë universitare, sepse janë universitetet dhe jo koeficientët, ato që vendosin më parë për radhën e përcaktuar në zgjedhje dhe janë universitetet ata që vendosin, përmes kriterëve profesionale të përcaktuara në departamente sa dhe si duhet të përmbushë parakushtet një kandidat për student në një program të caktuar, në mënyrë që të ketë sukses në programin që ai zgjedh për të vazhduar studimet e larta.

Ky është viti i tretë i implementimit të kësaj reforme, i cili hedh poshtë të gjitha paragjykimet dhe kritikën që u servirën me shumicë në vitin e parë, kjo edhe për një fakt tjetër se ky do të ishte një sistem, i cili do të favorizonte institucionet e arsimit të lartë privat. Përkundrazi, kjo tregon të kundërtën, jo vetëm që favorizon institucionet e arsimit të lartë publik dhe disfavorizon institucionet e arsimit të lartë privat, por vë në të njëjtat kushte të meritë/preferencës dhe të njëjtat mënyra përzgjedhjeje, duke respektuar maksimalisht të njëjtat standarde për të gjithë ata studentë që zgjedhin me dëshirën e tyre të vazhdojnë studimet në një institucion ose një tjetër. Këtë e tregojnë edhe shifrat, të cilat do t'i përmend më poshtë.

Ne jemi sërish në ato trende, ku 80% e studentëve kanë zgjedhur universitetet publike për të vazhduar studimet dhe vetëm 20% e tyre janë në universitetet private.

Më lejoni të përmend të gjitha masat që ne kemi ndërmarrë, për të pasur një vit akademik normal dhe konform standardeve ligjore. Sigurisht, kjo është paraprirë me disa akte normative dhe vendimmarrje të Këshillit të Ministrave, siç ishte përcaktimi i notës mesatare, kufiri i poshtëm, nota 6, për të vijuar në programet *bachelor* dhe në kuadër të reformës së ndërmarrë në mësuesi, për të përcaktuar një nivel më të lartë të notës mesatare, notën 7, për të gjithë studentët që do të zgjidhnin programet e mësuesisë. Po ashtu, me udhëzimin përkatës nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit për procedurat e aplikimit, përcaktohet një

vendimmarrje në kohën e duhur, por edhe shumë e vëmendshme, duke pasur parasysh ecurinë e portalit *u-albania* në vitet e para nga universitetet, për të përmirësuar dhe informuar edhe ata vetë nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta në ditët e hapura me gjimnazistët, që të orientojnë karrierën, ashtu sikurse sistemi ynë arsimor kishte programuar një plan shumë të qartë dhe të detajuar kontaktesh për të informuar gjimnazistët për kriteret apo për përzgjedhjen që do të bënin për arsimin e lartë.

Kjo fushatë informuese, po ashtu edhe përcaktimi në kohë i detyrimeve që rrjedhin nga ligji i arsimit të lartë për institucionet e arsimit të lartë me kriteret, kuotat dhe tarifat, bëri të mundur jo vetëm informimin në kohë, por ishte edhe një vlerë e shtuar, që ne të mos kishim asnjë lloj problemi. Unë dua të them që sistemi ka funksionuar sahat dhe çdo kandidat për student e kishte në kohë reale në celularin e tij se si do të ecte vijimësia dhe, nga ana tjetër, ai ishte një sistem i mbrojtur nga çdo lloj ndërhyrjeje tjetër që mund ta kalonte meritën. Besoj se edhe regjistrimet tregojnë një situatë të re lidhur me rritjen e cilësisë në pranimet për vitin e parë.

Unë dua të ndalem dhe t'ju informoj ju, deputetë të nderuar, lidhur me shifrat për kuotat dhe studentët e pranuar:

Në ciklin e parë të studimeve në *bachelor* dhe në programet dyvjeçare profesionale publike dhe private, përkatësisht në universitetet publike ishin përcaktuar 22 376 kuota dhe në private 15 341 kuota. Studentë të regjistruar në institucionet e arsimit të lartë publik kemi 17 536, mbi 80% e të gjithë atyre që aplikuan për të vijuar studimet e larta, dhe në universitetet private 4 766 studentë, dhe në total 22302 studentë. 75% e studentëve të pranuar në universitete janë me notën mesatare mbi 7. Për këdo që ka ndonjë lloj dileme për këtë arsytim, më lejoni t'ju bëj me dije se ka një përputhje reale midis arritjeve të çdo nxënësi me kriteret e shpallura nga universiteti, edhe brenda të njëjtës notë mesatare. Për shembull, nëse unë dhe kolegja kemi të njëjtën notë mesatare dhe të dyja aplikojmë për inxhinieri informatike, patjetër që universiteti, me kriteret që ka përcaktuar, kërkon që brenda të njëjtës notë mesatare, një grup lëndësh të caktuara kërkojnë një mesatare të caktuar, gjë që tregon se ka një garanci më të madhe për këta studentë, që nesër të kenë sukses në programet që kanë zgjedhur, sepse kërkesa me meritën është më shumë e përputhur sesa ishte në sistemin e vjetër.

Ajo që dua të ndaj me ju ka të bëjë me faktin se prioritet i këtij viti akademik ka qenë mësuesia. Për programet e mësuesisë ne shpallëm notën mesatare mbi 7. Në programet e mësuesisë jo vetëm që nuk ndodhi ajo që mendonin se programet e mësuesisë do të mbeteshin bosh, por ne sot kemi të regjistruar në mësuesi 3 672 studentë, ku 97% e të cilëve janë në universitetet publike dhe vetëm 3% në universitetet private, dhe 100% e tyre janë me notën

mesatare mbi 7. Ky është një hap tejte cilësor jo vetëm për këta studentë, që janë pranuar në programet përkatëse të mësuesisë, por besoj se është një hap i madh dhe një kthesë e madhe në atë që nesër do të jetë cilësia e tërë sistemit arsimor, ku kjo cilësi e re e mësuesve do të injektohet në shkolla.

Më lejoni t'ju them se pranimet në universitete, krahasuar me vitin 2017, ku ne kishim 27,58% të mësuesve me mesatare nën 7, sot 54% të studentëve ne i kemi në fashën nga 7-8, 38% të tyre në fashën 8-9 dhe 8% në fashën e notës mesatare nga 9-10. Reforma që kemi marrë në këto vite ka bërë të mundur që të gjitha diplomat e mësuesisë, të cilat dilnin nga universitetet e mbyllura apo sistemi *part time*, portali “Mësues për Shqipërinë” mundësoi që nga ky grupim i madh diplomash, të dalin vetëm më të mirët.

Nëse në vitet 2013-2014 notën mesatare nën 6 e kishin 362 kandidatë, mendoni se çfarë mësues mund të ishin në sistem, në vitin 2014-2015 e kishin **358** kandidatë, në vitin 2015 e kishin 266 kandidatë dhe në vitin 2016 e kishin 0 kandidatë, ku nota mesatare është 6. Lidhur me këtë, ne kemi bërë një analizë shumë të rëndësishme, të cilën e ndamë me studentët e ekselencës, sepse është bërë realitet që të gjithë studentët që kanë një notë mesatare mbi 9 dhe kanë zgjedhur mësuesinë, jo vetëm përjashtohen nga tarifat e shkollimit, por do të kenë edhe një bonus prej 1 mijë dollarësh në vit.

Dua të ndaj me ju edhe diçka tjetër, e cila ishte risi në sistemin tonë të arsimit të lartë, që është prania e programeve dyvjeçare profesionale, ku kemi 47 programe të tilla. Unë besoj se do të ketë një histori suksesi për të gjithë ata nxënës dhe maturantë, të cilët nuk e kanë të mundur të jenë fitues në degët e mjekësisë, inxhinierisë, pse jo, edhe të mësuesisë, por që kanë aftësinë. Ne kemi detyrimin që brenda dy vjetësh ata të profilizohen në programe dyvjeçare profesionale dhe të kenë sukses në tregun e punës, duke mbyllur në një kohë më të shpejtë edhe hendekun që ekziston midis ofertës akademike dhe nevojave të tregut të punës. Nëse një vit më parë ne kishim vetëm 23 programe profesionale dyvjeçare, sot kemi 70 programe profesionale dhe kemi 1655 studentë të regjistruar me një ndarje gjeografike në Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë dhe Tiranë, ku universitetet janë bërë të vetëdijshme për nevojën që vetë institucionet e arsimit të lartë kanë për t'u kthyer në qendra të zhvillimit të zonës, duke iniciuar dhe duke mundësuar në institucionet e tyre, këtu u referohem universiteteve të rretheve, programe studimi, që janë të lidhura me tregun e punës apo me zhvillimin e zonës, ku këto universitete ndodhen. Kjo ka qenë një iniciativë shumë e mirë, sepse ka qenë një proces i studiuar dhe i drejtuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, që vakumin, i cili krijohet në disa profile të caktuara apo programe të caktuara në këto universitete, për shkak edhe të rritjes së notës mesatare, si notës 6 në *bachelor*, po ashtu edhe të notës 7, në studimet e

mësuesisë, këto universitete të kishin mundësinë ta rikuperonin, duke filluar procesin e formimit në programet e reja dyvjeçare.

Është e rëndësishme të themi se edhe pse në institucionet e arsimit të lartë publik ne kemi pasur 15 programe të tilla dyvjeçare dhe pjesa tjetër i takon arsimit të lartë privat, numri më i lartë i të pranuarve është pikërisht në institucionet e arsimit të lartë publik dhe jo atij privat.

Këto janë shifrat e para dhe ne patjetër që po shikojmë edhe situatën që ka të bëjë me disa universitete. Këtu i referohem universitetit të Gjirokastrës, Elbasanit, por edhe universiteteve të tjera, të cilat lidhen me numrin e ulët të të regjistruarve në disa programe, kryesisht të mësuesisë, ku ne kemi pasur diskutime dhe tryeza komunikimi me drejtuesit e këtyre institucioneve, si dhe dekanët e fakulteteve, që kanë programet e edukimit, në mënyrë që edhe ato të rishikojnë riorganizimin dhe të gjithë punën e tyre dhe të kemi një situatë të përmirësuar.

Në fakt, unë dua të ndaj me ju edhe shqetësimin që lidhet me universitetin e Gjirokastrës, ku rrezikohen gati 10 programe. Nuk mund të themi që janë mbyllur, sepse ligji parashikon që që të mbyllet një program studimi, duhet që në dy vjet radhazi të mos ketë asnjë student të regjistruar, por duke iu referuar se si ka qenë performanca e të gjithë studentëve që vinin nga këto programe studimi nga universiteti i Gjirokastrës, shkon: në vitin 2014 - 66% e tyre kanë mbetur në provimin e licencës; në vitin 2015 përsëri 66% e tyre kanë mbetur; në vitin 2016 - 58%; në vitin 2017 - 62%, një mesatare që shkon në 63%. Pra, 63 e të gjithë studentëve që vijnë nga këto programe janë mbetës. Ky moment nuk duhet parë si negativ në kuptimin e funksionimit të këtyre programeve, por duhet parë si një moment shumë i rëndësishëm, ku, së pari, institucionet e arsimit të lartë duhet të rishikojnë gjithçka që ofrojnë në kurrikulën e tyre, me qëllimin për ta përmirësuar. Në interes të publikut është edhe fakti se çfarë prodhojnë këto institucione në programet e mësuesisë, sepse ato do të impaktojnë më pas të gjithë sistemin.

Po ashtu, ne kemi realizuar të gjithë analizën edhe në programe të tjera, të cilat lidhen me universitetet e Elbasanit, Korçës, Vlorës dhe Shkodrës. Sigurisht, kemi disa programe që rrezikojnë në degë të caktuara. Unë ju bëj me dije se në 104 programet e reja të hapura këtë vit, 47 prej të cilave janë profesionale, pjesa tjetër janë të programit të nivelit *bachelor*, janë programe që kanë pasur studentë dhe besoj se kanë krijuar një hapësirë të re edhe për vetë institucionet, për të parë në mënyrë shumë më të përgjegjshme të gjithë momentin kur përcaktojnë jo vetëm programet e reja, por kuotat dhe të gjitha procedurat që çojnë deri në procesin final të regjistrimit dhe të fillimit të vitit të ri akademik.

Ndaj, ajo që dua të them në fund është se ky vit akademik përmbushi të gjitha pritshmëritë që kishim në kuadër të reformës në arsimin e lartë me theks kryesor cilësinë. Që

në krye të herës, nuk kemi interes që institucionet e arsimit të lartë të jenë institucione ku “parkohen” të rejat dhe të rinjtë e papunë për të shpenzuar disa vjet të jetës së tyre në këto institucione. Pra, nuk është thjesht një qëllim në vetvete sasia, por prioritet për ne mbetet cilësia se çfarë dhe si ato performojnë jo vetëm kur operojnë, por me atë që do të jetë nesër nevojë e tregut të punës dhe suksesi i të gjithë të diplomuarve në këto institucione të arsimit të lartë. Pra, ne morëm mbrapsht gjithçka që ishte qëllim, kur përcaktuam si prioritet mësuesinë, dhe kemi shënuar kthesë, se vitet kalojnë shpejt.

Unë po ju them se kemi një armatë të rinjsh dhe të rejash në programet dyvjeçare profesionale, të cilët do të mbushin shumë shpejt hendekun e gjithçkaje që sot kërkohet nga sipërmarrja, por jo vetëm, në profesione të caktuara në tregun e punës. Pa dyshim që vetë universitetet kanë kuptuar nevojën për të qenë shumë më racionalë, pse jo, edhe më seriozë dhe të përgjegjshëm, në momentin kur vendosin për kuotat e studimit në programe të caktuara, në mënyrë që të mos i krijojnë institucionit të tyre një situatë jo të mirë për sa u përket marrëdhënieve me publikun, ndërkohë që shikohet se nuk përmbushen të gjitha kuotat që janë përcaktuar. Kjo nuk vjen nga fakti se jo gjithmonë studentët janë aty dhe nuk i preferojnë këto programe studimi, por se shpesh përcaktimi i kuotave nuk bëhet në mënyrë racionale dhe analitike për të parë historikun e këtyre programeve.

Edhe një herë, ju falënderoj për vëmendjen! Jam e gatshme t’i përgjigjem çdo pyetjeje që ju do të keni.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja ministre!

Kolegë, ju ftoj të bëni pyetje apo të shprehni ndonjë ide që keni.

Po, zoti Bujar, për procedurë.

Bujar Çela – Ministria ishte shumë korrekte për sa i përket shpjegimit shterues që bëri.

Them t’i japim fjalën shokut Ismet të flasë në emrin tonë.

Ismet Beqiraj – Bujari, kolegu ynë i nderuar, të frymëzon, por unë më shumë u frymëzova nga raportimi i zonjës Nikolla. Është një informacion i shkurtër, por shumë i koncentruar për të gjithë punën voluminoze që institucionet e arsimit të lartë bëjnë në Shqipëri. Singerisht, sot po raportoj lidhur me faktin se si ka filluar viti i ri akademik.

Kur ne mendojmë për raportimin në fillim të vitit të ri akademik, pyesim se si ka funksionuar ligji i implementuar ose i miratuar për institucionet e arsimit të lartë në vitin 2015, të gjitha aktet e tjera nënligjore ose paketën e plotë e akteve nënligjore, që bëjnë të mundur eficiencën ose vënien në funksion të plotë të këtij ligji.

Unë, duke punuar në këtë sektor, kam impresionet e mia. Skema e konkurrimit funksionoi në mënyrë ekselente në të gjitha hallkat e zinxhirit, nga informimi, trajnimi dhe edukimi paraprak nëpërmjet institucioneve të arsimit parauniversitar, pra që në shkollat e mesme dhe deri të marrja e përgjigjeve direkt *online* të studentëve, të cilët e ndiqnin me shumë interes dhe kishin kohën e mjaftueshme për të zgjedhur ato degë që dëshironin mbi bazën e konceptit meritë-preferencë. Vendosja e kriterëve të pranimi nga vetë fakultetet dhe brenda fakulteteve nga vetë departamentet, bëri të mundur që, ashtu sikurse e ka pasur kjo maxhorancë në filozofinë e saj, institucioneve të arsimit të lartë t'u jepet autonomi, dhe këtë radhë ishte një autonomi e zbatuar.

Unë gjej rastin që në këtë dëgjese jo vetëm të komplimentoj dhe të them fjalët më të mira për ministrinë, për ministren dhe të gjithë stafin e saj, por edhe për organet e zgjedhura dhe drejtuese në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, sepse vlerësuan dhe vetëvepruan në drejtim të kompetencave që kishin, falë edhe plotësimit të plotë të paketës me aktet nënligjore.

Zonja Ministre tha shumë risi të fillimit të këtij viti, por do të shtoj edhe disa të tjera. Cila është risia e plotë?! Ky vit filloi me paketën e plotë ligjore të zbatuar dhe jo më të eksperimentuar për të parë se si do të ecte. Risia tjetër ishte që jo vetëm u vendos mesatarja për rekrutimet për programet e mësuesisë, por pati një dyndje nga studentët dhe nga nxënësit ekselentë, e shoqëruar kjo edhe me mbështetjen financiare, ku Kryeministri i kësaj qeverie deklaroi mbështetjen 100% financiare të këtyre studentëve. Nuk e di shifrën e saktë, por nga ajo që është reklamuar, është deri në 300 studentë ekselentë. Kjo do t'i japë një ndihmesë dhe një shtysë shumë të fuqishme edhe përgatitjes së materialit kryesor që na vjen nga arsimi parauniversitar.

Nga ana tjetër, sikurse u tha dhe nuk kam pse mos e përsëris, kriteret e pranimi janë ekskluzivitet i çdo departamenti dhe sipas profilit të arsimimit dolën eficiente. Sigurisht, edhe tarifat janë në nivele të pranueshme dhe kufijtë limitë që ka vendosur qeveria janë në përputhje të plotë me mbështetjen e shtresave sociale, përveç paketave të veçanta. Ne kemi rastin që edhe në këtë periudhë, kur diskutohet edhe projektbuxheti, të shohim se janë parashikuar paketa të veçanta sociale për shtresat në nevojë.

Për sa u përket risive, për të cilat ministrja u tregua e kursyer për t'i thënë, është edhe akomodimi dhe komforti që është krijuar për studentët në Qytetin Studenti. Qeveria e ka në vëmendje faktin që Qyteti Studenti të bëhet një nga qytetet më model për jetën e atyre, të cilët lënë familjet dhe i përkushtohen dijes, shkencës dhe kulturës.

Çfarë mbetet për t'u sugjeruar? Përmirësimi i kriterit të cilësisë për pranimet në institucionet e arsimit të lartë. Në qoftë se vjet, qeveria dhe ministria, morën nismën për të

vendosur mesataren 7, me të drejtë në fillim edhe nga kolegët tanë, të cilët fatkeqësisht nuk i kemi përballë, kishte ndjenja skepticizmi, sepse do të shkonin, do të plotësoheshin kuotat, do të hapeshin këto degë, por ndodhi ndryshe. Ndaj, gjej rastin të sugjeroj që një nismë me interes do të ishte që kjo mesatare, si hap i pare, të implementohet dhe të injektohet edhe për programet e tjera, ndoshta jo në nivelin e notës mesatare 7, por 6,5, në mënyrë që ne të nxjerrim mjekë të shkëlqyer, inxhinierë të shkëlqyer dhe shumë të mirë, si dhe shumë profesione të tjera të domosdoshme. Madje, jo vetëm kaq, por e shikoj si evidente dhe të domosdoshme për të rritur cilësinë e programeve përveç kriterit të kuotave, që e kanë në tagër ta propozojnë departamentet dhe fakultetet, të vendoset edhe mesatarja. Unë e kuptoj që selektimi bëhet mbi bazën e kuotave, por ka ardhur koha që, si në të gjitha vendet e BE-së, ata që do të marrin titullin “Doktor”, “Inxhinier”, “Ekonomist” të mos jenë studentët që janë hequr zvarrë gjatë gjithë programit mësimor të *bachelor*-it. Sigurisht, për shkak të hapjes së këtyre programeve, bëhet edhe një sforcë në emër të mbajtjes hapur të këtyre degëve, por tregu në Shqipëri tashmë ka nevojë për specialistë të aftë.

Suksese në nisma dhe në ambicie të tjera për realizimin e plotë të objektivave që kjo maxhorancë i ka jo vetëm për këtë vit akademik, por edhe për vitet e tjera që do të pasojnë.

Ju faleminderit!

Milva Ekonomi – Ju faleminderit, Ismet!

Po, Vilma.

Vilma Bello – Faleminderit, kryetare!

Zonja Ministre, ju përshëndes ju dhe të gjithë stafin për gatishmërinë, për gjithë përkushtimin dhe të gjithë informacionin që na jepni, më së shumti për të gjitha reformat e nisura dhe që kanë vazhduar edhe më mirë së në fillimin e tyre.

Unë jam shumë dakord jo vetëm me ato që tha kolegu im, Ismeti, por ajo gjë, për të cilën do të doja të ndalesha më shumë dhe do ta rithosha, lidhet me arsyen e thjeshtë që unë vetë jam një prej pedagogeve të stafit të Fakultetit të Edukimit dhe nisma që tashmë është e realizuar dhe pranimi i studentëve me një mesatare mjaft më të mirë së më parë, pra pranimi i studentëve shumë të mirë në këto degë, sigurisht që ka bërë që këto degë të marrin peshën dhe vlerësimin e duhur, si dhe vëmendjen e politikave të qeverisë e të ministrisë.

Nga ana tjetër, do të doja të përgëzoja jo thjesht në emrin tim personal, por edhe të universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës për bashkëpunimin tuaj të frytshëm në kërkesën e bërë nga ky universitet për nxjerrjen e një VKM-je dhe krijimin e lehtësirave për ndërtimin e një godine të re të universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës. Tani është referuar një kërkesë në bashki për leje dhe është në rrugën e duhur. Kjo do ta rrisë universitetin e Vlorës jo vetëm nga

pikëpamja infrastrukturore, por do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në cilësinë e procesit të mësimdhënies në atë universitet.

Unë kam vetëm një pyetje: në çfarë raporti qëndron regjistrimi i studentëve në institucionet e larta private të arsimit në vitin akademik 2018-2019 përballë regjistrimeve në institucionet private në vitet 2017-2018?

Ju faleminderit edhe një herë! Ju uroj punë të mbarë!

Milva Ekonomi – T’i grumbullojmë pyetjet për ministren, pastaj të japë përgjigje.

Adelina Rista – Zonja Ministre, unë ju falënderoj për paraqitjen tuaj për prezantimin e fillimit të vitit të ri akademik 2018-2019!

Ky është një vit i ri mësimor që filloi me risi, me rritje të cilësisë së studentëve në të gjitha degët e universiteteve, me programe të tjera studimi etj..

Dihet që dija kalon nëpërmjet bankave të shkollës dhe bankave të auditorëve. Reforma në arsim pikërisht këtu ka mëshuar. Përveç infrastrukturës mbështetëse për shërbimet arsimore në drejtim të ofrimit të cilësisë, që është kryesorja në drejtim të atyre që na e ofrojnë transmetimin e njohurive, përgatitjes së stafit mësimdhënës, përgatitja e stafit mësimdhënës fillon që nga përzgjedhja, nga ata që do të shkojnë të studiojnë për degët e mësuesisë. Kriteri i vendosjes së notës mesatare 7 është pikërisht një start i mirë, e mbështes atë që tha Vilma, dhe i jep rëndësinë e peshën e duhur degëve të mësuesisë, të cilat deri para pak vitesh ishin degët më të braktisura ose ishin lënë të dorës së dytë. Në këtë fokus, desha të bëja një pyetje: si ka ndikuar vendosja e kriterit të notës mesatare te pranimi i studentëve? Si është numri i studentëve që kanë shkuar për mësuesi në raport me vitin e kaluar, është në rritje apo në zbritje?

E dyta, në fakultetet jashtë Tiranës sa është numri i studentëve në degët e mësuesisë? Është në rritje apo në zbritje?

Faleminderit!

Milva Ekonomi – A mund të bëj edhe unë një pyetje të fundit, meqenëse kemi disa kërkesa që kanë ardhur herë pas herë në komision? Për të marrë një licencë për një kolegji profesional dyvjeçar, a ndiqen të njëjtat kritere dhe e njëjta rrugë si të marrësh një licencë për në universitet? Po flas për kolegjet profesionale private, ngaqë ka kërkesa të shumta, që kërkojnë informacion për këtë gjë. Mund ta thoni ju, ngaqë është informacion publik dhe ata që kanë bërë kërkesë e dëgjojnë nëpërmjet jush.

Ju lutem, vetëm jepni një informacion!

Lindita Nikolla – Nuk e di nëse kjo ka shumë rëndësi për raportimin për vitin akademik, por patjetër janë një sërë kërkesash, që unë nuk mund t’i listoj këtu, janë standarde,

nuk janë njësoj si për një kolegji profesional, ashtu edhe për një universitet, por janë të publikuara në *website*-n e Ministrisë së Arsimit, ku mund të informoheni.

Faleminderit!

(*Ndërhyrje pa mikrofon.*)

Lindita Nikolla - Në fakt, dua të bëj një saktësim, kur pyesni nëse duhet të vendosim mesataren edhe për programet e tjera, vendosja e kufirit të mesatares 6 është një kufi i poshtëm, që ndan dy programe studimi të ciklit të parë, programin *bachelor* dhe programin dyvjeçar. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton që gjithë ata maturantë që e kanë notën mesatare nën 6, nuk kanë të drejtë të vijojnë studimet e tyre në një program *bachelor*, por në programet dyvjeçare. Nga ana tjetër, kjo nuk do të thotë se të gjithë ata që e kanë notën mesatare mbi 6 sot kanë shkuar për mjekësi, sepse vetë universitetet kanë përcaktuar një kufi për notën mesatare. Për shembull, mjekësia e ka 8,5 nivelin fundor për notën mesatare. Nga ana tjetër, ka edhe një sërë kriteresh, prandaj u përpoqa ta shpjegoja se si e bën ligji dhe sistemi i ri përputhjen më të mirë midis meritës dhe preferencës, në mënyrë që këta maturantë jo vetëm të shkojnë te degët që preferojnë, por të vendosen edhe disa kriterë, që i përcaktojnë vetë departamentet. Pra, mjekësia e ka kufirin e poshtëm 8, 5, por jo të gjithë që e kanë 8,5 mund ta marrin, sepse ka disa kriterë për grup lëndësh që e rritin edhe më shumë konkurrencën. Ndaj, edhe te mjekësia kemi një konkurrencë të fortë, po kështu tek inxhinieria, por edhe te programet e tjera. Pra, mesatarja 6 i bën patjetër fitues, çdo universitet ka kriteret e tij. Në fakt, specifikisht këtë e kanë universitet publike.

Nga ana tjetër, ajo që ndodhte rëndom ishte fakti se në programet e mësuesisë ishte lënë nota mesatare mbi 6 dhe mund të futeshe në programet e mësuesisë. Sigurisht, edhe aty kishte një rankim në bazë të kuotave, por për maturantët mësuesia ishte kërkesa e fundit dhe mbetej gjithmonë e më shumë kërkesa për maturantët më të dobët. Sot ne kemi vendosur që për mësuesinë të kemi kufi të poshtëm notën mesatare 7, pra vendimi i Këshillit të Ministrave thotë: “Çdo maturant që e ka notën mesatare nën 7, sistemi nuk e lejon që të aplikojë për një program mësuesie”. Këtu janë diferencat që bën sistemi për notën mesatare 6 dhe 7, por patjetër universitetet kanë kriteret e tyre, qoftë edhe me notën mesatare. Pra, është një garë shumë e forte; mund t’ju jap disa të dhëna paraprake. Ne vendosëm notën mesatare 7 te mësuesia, pasi bëmë disa analiza, disa projeksione, duke iu referuar të regjistruarve të një viti më parë dhe e dinim që sivjet do të kishim më pak të regjistruar në mësuesi, sepse nuk kishte kuptim të ndodhte ndryshe. Por nuk ndodhi ajo që mendohej, që programet e mësuesisë do të mbylleshin. Mësuesia ka mbetur e treta, është e treta për të gjithë numrin e të regjistruarve. Ka ndryshuar

disi spektri, kemi ekonominë të parën, shkenca sociale dhe politike të dytën, i katërti infermiera, i pesti juridiku e kështu e me radhë të gjitha fushat e tjera.

Nëse iu referohemi notave mesatare, po them mesataren e mesatareve, pa bërë atë reflektimin me kriteret e universitetit, pra mesatare me VKM, që përcaktohet në ekonomi, domethënë, nota mesatare e të gjithë të regjistruarve është 7,77; në juridik 7,88; në teknologji 7,9; në infermieri 7,39; në inxhinieri 7,4; në shkenca politike dhe sociale 7,41; në shkenca natyrore 7,71; në ndërtim dhe arkitekturë 7,77. Pra, fakti që ne kemi vendosur këto kritere fundore që lidhen me notën mesatare, tregon për një impakt pozitiv. Nga ana tjetër, kjo nuk u shoqërua me shpatë, më falni për termin, për të ndarë sistemin, por në mënyrë të studiuar u zgjerua mundësia, ku të gjithë ata studentë që nuk mund të ishin fitues për shkak të garës së forte, të kishin mundësi të shkolloheshin në programe dyvjeçare, që sërish janë arsimi i lartë dhe që i aftëson ato shumë më shpejt për të arritur sukses në tregun e punës. Fakti që ne kemi rritje ekstreme të studentëve në programet dyvjeçare, tregon se gjithnjë dhe më shumë ato po ndërgjegjësohen. Madje, ka edhe një tregues interesant, edhe në programet dyvjeçare 27% e të regjistruarve e ka notën mesatare mbi 6. Pra, edhe pse kanë pasur mundësinë që të shkonin dhe të aplikonin në një program *bachelor*, janë regjistruar dhe thonë më mirë: “Unë vijoj studimet në një program dyvjeçar, në mënyrë që t’i drejtohem më shpejt tregut të punës”. Kështu që, kjo është ajo që doja të sqaroja për sa i përket vendosjes së notës mesatare për programet e tjera.

Nga ana tjetër, pyetjes në lidhje me raportin që qëndron te të regjistruarit në arsimin publik me arsimin privat, raporti edhe një vit më parë ka qenë i tillë, pra trendi është 80% me 20%, ku 80% është në publik dhe 20% është në privat, që mund të shkojë 79% me 21%. Por ky ka qenë trendi jo vetëm vjet, por edhe një vit më parë, pra që kur ka filluar të funksionojë ligji i ri i arsimit të lartë.

Si ka ndikuar provimi te pranimi në mësuesi? Ne në shifra kemi rënie nga një vit më parë, por atje janë 100% studentë që kanë notën mesatare mbi 7. Ky ishte qëllimi i gjithë kësaj reforme.

Në Universitetin e Tiranës kuotat janë plotësuar 100% në programet e mësuesisë. Kemi rënie në disa programe të universitetet e rretheve, për të cilat unë nuk dua të bëj reklamë negative, por duhet t’ju them se është mirë që ndodhi ashtu, sepse të shpenzosh 5 vjet nga jeta jote për t’u formuar në mësuesi dhe më pas këta studentë, 66% e tyre, mbeten në licencë, kjo tregon se ka një gjë që nuk shkon dhe duhet riadresuar në mënyrë të plotë. Kjo ka qenë pjesë e tryezave dhe e diskutimeve me universitetet, të cilët jo vetëm janë shumë të mirëkuptuar, por kanë filluar nga puna për modernizimin e kurrikulave, për të parë edhe një sërë programesh, në fakt, që ishin shtuar në mënyrë të pakuptimtë dhe pa asnjë lloj kontrolli se çfarë ndodh nesër

me këta studentë që diplomohen, sa janë të aksesueshëm në tregun e punës. Për shembull, ne kishim programe ku nuk ka të regjistruar, profili gjuhë-letërsi minor arte ose fizikë kompjuterike. Profesori që kam në krah është një shkencëtar dhe thotë se nuk e di se çfarë mund të dalë nga ky lloj programi. Pra, është një moment shumë i rëndësishëm që duhet të shikohet me shumë seriozitet. Ky është një moment për të reflektuar edhe institucionet e arsimit të lartë, në mënyrë që të bëjnë me përgjegjësi gjithçka që kanë tagër ligjor për ta bërë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse u referohemi kuotave, pothuajse janë 22 mijë e 376 kuota në publik, 15 mijë 541 kuota në privat. Kur i shikon kuotat të duken aty-aty, ndërsa kur shikon numrin e të regjistruarve, vetëm 4 mijë e 700 kemi në universitetet private të regjistruar dhe e gjithë pjesa tjetër janë në universitet publike. Pra, jo vetëm ligji nuk bëri atë për të cilën u anatemua...

Milva Ekonomi – Në fakt, bëtë mirë që na kujtuat diçka. Herë pas here në komision janë ngritur shqetësime jo vetëm nga kolegët, por edhe nga njerëz të ndryshëm lidhur me tarifat që paguajnë studentët në universitetet tona publike dhe ka një ndjesi sikur tarifat janë rritur. Në fakt, ju, zonja ministre, na keni shpjeguar edhe një herë se si vendoset tarifa në këtë komision, por mbase do të ishte i drejtë edhe një shpjegim tjetër për tarifën.

Lindita Nikolla – Faleminderit, zonja drejtuese!

Përfitoj edhe nga pyetja juaj, por edhe nga nevoja që kemi për t’u shpjeguar sa herë që dëgjojmë nga drejtues të lartë, madje edhe nga kryetari *de facto* dhe *de jure* i opozitës, që flasin për 6-fishim dhe 5-fishim, si ta kenë momentin për të treguar se sa fish janë rritur tarifat, një gjë krejtësisht e pavërtetë. Nga viti 2014 dhe deri në momentin që flasim tarifat kanë mbetur të njëjta. Pra, hyrja e ligjit të ri në fuqi në vitin 2015 nuk ka bërë rritjen e tarifave, por e kundërta është e vërtetë. Ne do të demonstrojmë edhe vendimmarrje të bordeve të administrimit të universiteteve. Për shembull, universiteti i Vlorës në disa programe të caktuara sivjet ka ulje të tarifave. Me ligjin e ri të arsimit të lartë, tagrin për vendosjen e tarifave e kanë universitet. Qeveria ka përcaktuar kufirin maksimal, në mënyrë që të mos kemi asnjë lloj abuzimi për të kaluar nga një kufi që shikohet si normal, i vendosjes së një tarife studimi. Pra, nga viti 2014 dhe deri në momentin që flasim, nuk kemi asnjë ndryshim tarife. Megjithatë, ne kemi vendosur që ditën e hënë, dhe përfitoj nga rasti t’ju ftoj, të bëjmë një debat shterues, me shifra dhe me fakte, dhe të mos lejojmë askënd që të manipulojë opinionin publik me gënjeshtër, se çfarë ka ndodhur me tarifat e studimit në universitet.

Nëse në të gjitha raportimet e mia i referohem ditës së parë që kam marrë detyrën time si ministre, kësaj here, patjetër, do t’i referohemi edhe çfarë ka ndodhur me tarifat nga viti 2005

deri në vitin 2013, kur Partia Demokratike ka qeverisur edhe sektorin e arsimit të lartë, për të kuptuar njëherë e mirë se sa të pavërteta janë gjithçka që i adresohet këtij momenti në institucionet e arsimit të lartë. Janë universitetet që vendosin për tarifat, por po ju them se edhe universitetet nuk kanë rritur tarifat, përkundrazi ka disa vendimmarrje bordesh akreditimi në disa universitete të rretheve, ku për programe të caktuara për të incentivuar edhe pranimin dhe regjistrimin e numrit më të madh të studentëve, është parë e udhës që të ulen tarifat e studimit.

Gjithsesi, ditën e hënë publiku do të ketë një informacion të plotë nga ministrja e Arsimit, në prani të të gjithë administratorëve të universiteteve dhe bordeve të administrimit, që janë autoritetet që ligji i njeh për pjesën që lidhet me menaxhimin financiar, sigurisht edhe me ftesën për rektorët dhe drejtuesit akademikë të universiteteve tona. Kështu që, jeni të lutur të jeni pjesë e këtij debati.

Milva Ekonomi – Në çfarë ore e keni bërë ftesën për këtë takim?

Lindita Nikolla – Ne nuk e kemi bërë ende ftesën, sapo e bëmë.

Milva Ekonomi – Jo, kur e keni planifikuar takimin, sepse edhe ne, nisur nga fakti se projektbuxheti i vitit 2019 është shumë i rëndësishëm dhe ne bëjmë dëgjesa, të hënën kemi planifikuar dëgjesa me universitetet publike dhe i kemi ndarë në dy seanca, në fillim universitetet publike të Tiranës dhe, më pas, universitet publike që janë në rrethe. Kështu që, mbase do të ishte mirë që ju të na informoni pak për orën e takimit, që ne të koordinojmë aktivitetet, sepse i kemi të parashikuara.

Lindita Nikolla – Kur i keni ju?

Milva Ekonomi – Ne në orën 11:00, të hënën dhe, më pas, vazhdojmë.

Lindita Nikolla - E lëmë pasdite.

Milva Ekonomi – Po, shumë mirë!

Lindita Nikolla - Faleminderit!

Milva Ekonomi – Ju falënderojmë sërish, sepse bëmë shumë mirë që e bëmë këtë takim dhe që ju dëgjuam për këto gjëra, edhe pse ju kemi ndjekur nga mediet dhe nga të gjitha burimet e informacionit, sepse ka ende për të thënë, ngaqë është një ligj i ri dhe i ripunuar, dhe ka gjithmonë nevojë për më shumë përpunim.

Faleminderit, për informacionin!

Të nderuar kolegë, do të rrimë dhe një minutë që të diskutojmë për kalendarin e nesërm.

Nesër fillojmë në orën 9:30. Në fakt, duhej ta fillonim në orën 10:00, sipas kërkesës që bëri zoti Ismet, por ka mbledhje qeverie në orën 11:00, dhe thamë që nga ora 10:00 deri në orën 10:45 është e pamjaftueshme për ministren e Kulturës. Prandaj e afruam mbledhjen në

orën 9:30 dhe nuk e ndërronim dot, se e kishim caktuar datën. Në vend të zotit Ismet, për gjysmëorëshin e parë, do të kemi zotin Besnik Baraj, kështu që zoti Ismet është i mbuluar për nesër, në fillim të mbledhjes, dhe nuk krijojmë probleme, pastaj do të na bashkohet, sepse do të ketë përsëri dëgjesa.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Propozimi juaj ishte ose të hënë, ose të mërkurë dhe u realizua e mërkura. Staf i komisionit ka bërë një punë të mirë, sepse ka informuar të gjitha institucionet që kishim vendosur për mbledhjen e ditës së premte, të vijë ditën e mërkurë. Kështu që nesër përgatituni se dita është pak e gjatë, sepse kemi disa dëgjesa, pra kemi ministren e Kulturës, kemi Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, Radiotelevizionin dhe Qendrën Kombëtare të Kinematografisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne nuk jemi ende në dijeni, nëse nuk do të ketë seancë ditën e enjte.

MBYLLET MBLEDHJA